



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKT MARRËVESHJE**

NDËRMJET:

GRUPEVE TË INTERESIT PËRFAQËSUES TË AUTOSHKOLLAVE  
Shoqata “Kombëtare e Autoshkollave” dhe Shoqata e Autoshkollave “Siguria në  
Rrugë”)

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

DHE

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT  
RRUGOR

*Tiranë më \_\_\_/\_\_\_/2022*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GRUPEVE TË INTERESIT PËRFAQËSUES TË  
AUTOSHKOLLAVE**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,  
Tiranë më \_\_\_\_\_.2022

**“SHOQATA KOMBËTARE E  
AUTOSHKOLLAVE”**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,  
Tiranë më \_\_\_\_\_. 2022

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E  
SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR**

**SHOQATA E AUTOSHKOLLAVE  
“SIGURA NË RRUGË”**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,  
Tiranë më \_\_\_\_\_. 2022

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,  
Tiranë më \_\_\_\_\_. 2022

**AKT MARRËVESHJE  
LIDHUR NDËRMJET  
PALËVE**

**GRUPEVE TË INTERESIT PËRFAQËSUES TË AUTOSHKOLLAVE, SHOQATA “KOMBËTARE E AUTOSHKOLLAVE”** me numër identifikimi (Nipt) L71715471D, e regjistruar me Vendimin Nr. 1094 datë 16.07.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga “Hasan Sufa”, P. 2, Sh. 4, Tiranë, , përfaqësuar nga kryetari i shoqatës **Z. Agron Beja dhe SHOQATA E AUTOSHKOLLAVE “SIGURA NE RRUGË”** me numër identifikimi (Nipt) L81527454T, e regjistruar me Vendimin Nr. 5811 datë 09.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga “Muhamet Gjollësja”, pallatet Toena, kati 3, përfaqësuar nga kryetari i shoqatës **Z. Behar Laze**, të cilat kanë si mision të përbashkët të mbrojnë interesat e të gjithë anëtarëve që marrin pjesë në veprimtarinë e autoshkollave, si dhe të marrin pjesë në diskutimin e akteve ligjore për autoshkollat dhe sigurinë në rrugë.

dhe

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË TATIMEVE (referuar si DPT)** me seli në adresën: Rruga “Gjin Bue Shpata”, Tirana 1000, Tiranë është institucion që ka si mision

mbledhjen e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar njëtrajtësisht legjislacionin tatimor, për financimin e buxhetit të shtetit shqiptar, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **z. Ceno KLOSI**,

Si dhe

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR (referuar si DPSHTRR)** me seli në adresën: Rruga “Muhedin Llagani” Nr.10, Tiranë, është institucion shtetëror, me statusin e personit juridik publik, me vetëfinancim, në varësi të ministrit përgjegjës për punët publike dhe transportet, i krijuar sipas Vendimit Nr. 343, dt. 21.07.1999 "Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor" të Këshillit të Ministrave, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, **z. Blendi GONXHJA**,

në vijim të quajtura “palët”,

Nisur nga fakti se siguria rrugore është problem i gjithë shoqërisë dhe nuk mund të përmirësohet nëse do të konsiderohet përgjegjësi e një institucioni, dhe ku institucionet e ngarkuara, nuk arrijnë bashkëpunim e koordinim të veprimeve mes tyre dhe grupeve të interesit;

Të vetëdijshëm se situata aktuale e sigurisë rrugore paraqet problematika, si dhe vështirësi në përmirësimin e saj për shkak të mosndërgjegjësimit të përdoruesve të rrugës e cila duhet të fillojë nga përgatitja teorike dhe praktike në autoshkolla, pavarësisht masave parandaluese dhe administrative të ndërmarra ndaj tyre, nismave edukative e informuese lidhur për sigurinë rrugore;

Me qëllim rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional, kapaciteteve institucionale dhe profesionale, si dhe angazhimeve të secilit institucion përkatës dhe grupeve të interesit, për rritjen e sigurisë rrugore, në vendosjen e një ekuilibri ndërmjet masave parandaluese lidhur me shkeljet e përdoruesve të rrugës dhe të ligjshmërisë rrugore, përmes ndryshimeve të kuadrit ligjor dhe edukimit të grupeve specifike të interesit;

Në kuadrin e thellimit të bashkëpunimit dhe forcimit të partneritetit me tatimpaguesit e rregullt të përfaqësuar nga shoqatat e njohura juridikisht;

Të vetëdijshëm për rëndësinë e bashkëpunimit për forcimin e shtetit ligjor, për rregullimin e aktivitetit të autoshkollave;

*Me dëshirën e mirë për të kombinuar në bashkëpunim nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet dy palëve,*

*Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe grupet e interesit si Shoqata “Kombëtare e Autoshkollave” dhe Shoqata e*

*Autoshkollave “Siguria në Rrugë”, në cilësinë e Palëve në këtë Marrëveshje, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë deklarojnë se bien dakord, përta më poshtë:*

## **Baza Ligjore**

- 1.1 Ligji Nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- 1.2 Ligji Nr. 10081, datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- 1.3 Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimet e MF në zbatim të tij;
- 1.4 Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimet e MF në zbatim të tij;
- 1.5 Ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimet e MF në zbatim të tij;
- 1.6 Ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimet e MF në zbatim të tij;
- 1.7 Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 153, datë 7.4.2000, “Për miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- 1.8 Udhëzimi i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Nr. 9, datë 14.04.2022 “Për aktivitetin e autoshkollave”;

## **Neni 1 Objekti**

- 1.1 Objekti i kësaj Marrëveshje është dakordësimi ndërmjet subjekteve që organizojnë autoshkollat (grupet e interesit), Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor mbi përcaktimin e kostos minimale fiskale (tarifat e pagesës) së përgatitjes për drejtues mjeti për kategoritë: AM, A1, A2, A, B1, B, BE, C1, C, C1E, CE, D1, D, D1E, DE, për rimarrjen e lejedrejtimit pas humbjes totale të pikëve ose për heqje të saj si dhe për dëshmitë dhe certifikatat të aftësisimit profesional.
- 1.2 Bashkëpunimi midis palëve është i domosdoshëm dhe i rëndësishëm pasi ndihmon në luftën ndaj konkurrencës së pandershme, rregullimin e tregut të autoshkollave, kontribujm në kuadër të çështjes me rëndësi të madhe publike mbi Sigurinë Rrugore me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimit të sigurisë në rrugë, të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në një proces zinxhir duke filluar nga përdoruesit e rrugës dhe homogjeniteti i masave në këtë drejtim.

## **Neni 2**

Grupeve e interesit si Shoqata “Kombëtare e autoshkollave” dhe Shoqata e Autoshkollave “Sigura ne rrugë” në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, janë dakortësuar se tarifat e pagesës së përgatitjes për marrjen e njohurive teorike dhe njohurive pranktike për drejtues mjeti ( Kosto minimali fiskale K.M.F duke përfshirë dhe TVSH) për kategoritë: AM, A1, A2, A, B1, B, BE, C1, C, C1E, CE, D1, D, D1E, DE, ose për rimarrjen e lejedrejtimit pas humbjes totale të pikëve ose për heqje të saj si dhe për dëshmime dhe certifikatave të aftësisimit profesional (K.M.F) **do të jetë e njëjtë për të gjithë subjektet që zhvillojnë aktivitetin autoshkollë në Republikën e Shqipërisë të jetë sipas tabelës së mëposhtme dhe është pjesë përbërëse e kësaj marrveshje:**

Nr.	Kategoritë e lejeve të drejtimit, dëshmisë ose certifikatës	Kosto minimale fiskale për marrjen e njohurive teorike	Kosto minimale fiskale për marrjen e njohurive praktike	Kosto minimale fiskale për marrjen e kategorisë së lejedrejtimit, dëshmisë ose certifikatës
1	►Kategoria "AM " Kalim direkt tek AM	15,000	12,000	27,000
2	►Kategoria "A1 " Kalim direkt tek A1	30,000	15,000	45,000
3	" Kalim nga AM tek A1	15,000	13,000	28,000
4	" Kalim nga B1 tek A1	-	13,000	13,000
5	" Kalim nga B tek A1	-	13,000	13,000
6	►Kategoria "A2 " Kalim direkt tek A2	30,000	25,000	55,000
7	" Kalim nga AM tek A2	-	23,000	23,000
8	" Kalim nga A1 tek A2	-	23,000	23,000
9	" Kalim nga B tek A2	-	23,000	23,000
10	►Kategoria "A " Kalim nga A2 tek A	-	30,000	30,000
11	" Kalim nga B tek A	-	40,000	40,000
12	►Kategoria "B1 " Kalim direkt tek B1	30,000	25,000	55,000
13	" Kalim nga AM tek B1	15,000	23,000	38,000
14	" Kalim nga A1 tek B1	-	23,000	23,000
15	" Kalim nga A2 tek B1	-	23,000	23,000
16	►Kategoria "B " Kalim direkt tek B	30,000	55,000	85,000
17	" Kalim nga AM tek B	15,000	32,000	47,000
18	" Kalim nga A1 tek B	-	25,000	25,000
19	" Kalim nga A2 tek B	-	18,000	18,000
20	" Kalim nga A tek B	-	32,000	32,000
21	" Kalim nga B1 tek B	-	25,000	25,000
22	" Kalim nga Automatike B tek manuale B	-	30,000	30,000
23	►Kategoria "B 96" Kalim nga B tek B96	-	30,000	30,000
24	►Kategoria "C1 " Kalim nga nga B tek C1	30,000	25,000	55,000
25	" Kalim nga D tek C1	15,000	17,000	32,000
26	►Kategoria "C " Kalim nga B tek C	30,000	65,000	95,000
27	" Kalim nga C1 tek C	-	40,000	40,000
28	" Kalim nga D tek C	15,000	35,000	50,000
29	►Kategoria "D1 " Kalim nga B tek D1	30,000	55,000	85,000
30	" Kalim nga C tek D1	15,000	35,000	50,000
31	►Kategoria "D " Kalim nga B tek D	30,000	95,000	125,000
32	" Kalim nga C tek D	15,000	65,000	80,000
33	" Kalim nga D1 tek D	-	45,000	45,000

34	► <b>Kategoria "B-E "</b>	Kalim nga B tek B-E	-	45,000	<b>45,000</b>
35	► <b>Kategoria "C1-E "</b>	Kalim nga C1 tek C1-E	-	45,000	<b>45,000</b>
36	► <b>Kategoria "C-E "</b>	Kalim nga C tek C-E	-	55,000	<b>55,000</b>
37	"	Kalim nga D-E tek C-E	-	55,000	<b>55,000</b>
38	► <b>Kategoria "D1-E "</b>	Kalim nga D1 tek D1-E	-	50,000	<b>50,000</b>
39	► <b>Kategoria "D-E "</b>	Kalim nga D tek D-E	-	50,000	<b>50,000</b>
40	► <b>ÇAP Kualifikim mallra</b>		30,000	50,000	<b>80,000</b>
41	► <b>ÇAP Kualifikim udhtar</b>		30,000	65,000	<b>95,000</b>
42	► <b>Mjete të renda:</b> (Automakinistë; Eskavatoriste me goma; ..... Eskavatoriste me zinxhire dhe Buldozeriste)		30,000	35,000	<b>65,000</b>
43	► <b>Fitim i pikëve të humbura</b>		20,000	12,000	<b>32,000</b>

### Neni 3

3.1 Regjistrimi i personave të interesuar për t'u pajisur me lejedrejtimi bëhet në autoshkolla. Para lëshimit të lejes apo autorizimit nga DPSHTRR bëhet pagesa përkatëse, sipas kategorisë së lejedrejtimit, dëshmisë ose certifikatës.

Pagesa mund të bëhet në një bankë të nivelit të dytë. Tarifat e pagesës që paguan kandidati është sipas dakordësisë ndërmjet subjekteve që organizojnë autoshkollë e personave të interesuar, por jo më e ulët se kosto minimale fiskale e përcaktuar në nenin 2.

Mandatpagesa për përgatitjen e drejtuesve të mjeteve rrugore me motor, dëshmime ose certifikave depozitohet në dosjen e kandidatit, e cila do të jetë objekt kontrolli nga strukturat përkatëse të ngarkuara sipas legjislacionit në fuqi.

Datë regjistrimi të kandidatit është data e pajisjes me leje për përgatitjen e njohurive teorike ose me autorizim për përgatitjen e aftësive drejtuese e të sjelljes.

3.2 Regjistrimi i kandidatit nga ana e subjektit me aktivitet autoshkollë për zhvillimin e kursit të teorisë bëhet në Zyrat përkatëse të DRSHTRR-së, pas dorëzimit të dokumenteve të përcaktuara në nenin 311 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000, "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, miraton regjistrimin e kandidatit në kursin e përgatitjes teorike, pasi shqyrton plotësimin e kriterëve.

3.3 Për subjektet e regjistruar dhe që kanë detyrimin për të llogaritur dhe paguar Tatimin mbi Vleren e Shtuar (TVSH), TVSH e pagueshem do të jetë e barabartë me diferencën midis TVSH-së së llogaritur dhe TVSH-se së zbritshme të njohur sipas legjislacionin përkatës në fuqi.

3.4 Në asnjë rast Vlera totale = Vlera e Tatueshme + TVSH e faturuar nga secili subjekt i regjistruar për aktivitetin autoshkollë për çdo kandidatë për marrjen e njohurive teorike ose e për marrjen e njohurive praktike për secilën kategori lejedrejtimi, dëshmi ose certifikat nuk mund të jetë më e vogël se vlera e përcaktuar në këtë Marreveshje sipas tabelës në nenin 2.

3.5 Për efekt të llogaritjes së të ardhurave, vlera totale e faturuar nga secili subjekt i regjistruar për aktivitetin autoshkollë si për marrjen e njohurive teorike ose e për marrjen e njohurive praktike për secilën kategori lejedrejtimi, dëshmi ose certifikat nuk mund të jetë më e vogël se vlera e përcaktuar në këtë Marreveshje sipas tabelës në nenin 2.

3.6 Për efekt deklarimi ose kontrolli nga strukturat e DPSHTRR-së ose DPT-së, numri i kursantëve të regjistruar për marrjen e njohurive teorike ose e për marrjen e njohurive praktike për secilën kategori lejedrejtimi, dëshmi ose çertifikat do të nxirren nga sistemi informatik i DPSHTRR.

3.7 Liste pagesat dhe kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme.

- Koha e punës e instruktorit të praktikës në listë pagesat e sigurimeve shoqërore në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve të qarkut përkatës, të jete e lidhur online me kohën e programit për përgatitjen e njohurive praktike të kandidatëve për lejedrejtimi ~~me zyrën e regjistrimit të kandidatëve në Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor të rajonit përkatës.~~

- Koha e punës e drejtuesit teknik ose instruktorit të teorisë në listë pagesat e sigurimeve shoqërore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të jetë e lidhur online me kohën përgatitjes së njohurive teorike të kandidatëve për lejedrejtimi ~~me zyrën e regjistrimit të kandidatëve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.~~

#### **Neni 4**

#### **Përfaqësimet dhe Garancitë e Palëve**

4.1 Secila palë, në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje siguron palën tjetër që:

- a) Është e autorizuar të përmbushë të gjitha detyrimet e parashikuara nga kjo Marrëveshje;
- b) Përmbushja e detyrimeve të kësaj Marrëveshje, si dhe e të gjithë Marrëveshjes në tërësi nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi;
- c) Detyrimet e kësaj Marrëveshjeje janë të ligjshme, të vlefshme dhe të detyrueshme për t'u zbatuar.

4.2 DPSHTRR dhe DPT garantojnë se do të marrë masa për publikimin e kësaj marrëveshje në QBZ, në faqen e ëeb të DPSHTRR-së dhe DPT-së me qëllim që të njihet nga palët e interesuara.

4.3 Grupet e interesit garantojnë se do të njohin me këtë marrëveshje dhe detyrimet që rrjedhin prej saj, të gjithë anëtarët e shoqatës që përfaqësojnë. Mos marrja dijeni e subjekteve autoshkolla nuk i përjashton nga detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

4.4 DPT garanton se do të njohë me këtë marrëveshje Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

#### **Neni 5**

#### **Cënimi i ndonjë dispozite të Marrëveshjes**

5.1 Në rast se ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshje bëhet e pavlefshme, e paligjshme ose e pamundur për t'u zbatuar sipas legjislacionit në fuqi, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatimi i dispozitave të tjera të Marrëveshjes nuk çënohen;

5.2 Palët, në mirëbesim, mund të negociojnë për të zëvendësuar dispozitën e mësipërme me një dispozitë tjetër.

## **Neni 6 Amendimet**

6.1 Palët do të bëjnë amendime në këtë marrëveshje bazuar në ndryshimet e legjislacionit në fuqi edhe pëlqimin e ndërsjelltë të paraqitur me shkrim.

## **Neni 7 Koordinimi ndërmjet palëve**

7.1 Secila palë do të caktojë një person kontakti, që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit;

7.2 Komunikimi ndërmjet palëve do të jetë në formë shkresore ose elektronike në adresat zyrtare të palëve si më poshtë:

DPSHTRR: [dpshttr@dpshttr.gov.al](mailto:dpshttr@dpshttr.gov.al)

Shoqata “Siguria në Rrugë”:

“Shoqata Kombëtare e autoshkollave”: [sh.kombetare@gmail.com](mailto:sh.kombetare@gmail.com)

## **Neni 8 Zbatimi i marrëveshjes**

8.1 Palët marrin përsipër zbatimin e kësaj Akt Marrëveshje nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe do të përpiqen ti zgjidhin me mirëkuptim të gjithë mosmarrëveshjet që mund të rrjedhin gjatë zbatimit.

8.2 Çdo ndryshim i bërë, për aq sa ato lidhen me Akt Marrëveshje, do të reflektohen zyrtarisht edhe në ndryshimin e saj.

## **Neni 9 Hyrja në fuqi**



9.1 Kjo Akt Marrëveshje hyn në fuqi dhe bëhet e detyrueshme për t'u zbatuar 30 (tridhjetë) ditë pas botimit në fletoren zyrtare dhe i shtrin efektet për gjithë ata kandidatë që do të regjistrohen pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje. Për efekt të kësaj marrëveshje datë regjistrimi është data e pajisjes me leje për përgatitjen e njohurive teorike.

9.2 Marrëveshja është e vlefshme për një afat të pacaktuar.

9.3 Kjo Akt Marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë duke njoftuar paraprakisht me shkrim palën tjetër të paktën 1 (një) muaj më parë.

9.4 Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale, nga të cilat 1 (një) për Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, 2 (dy) për Grupet e Interesit dhe 1 (një) për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Nënshkruar në Tiranë, sot, më datë \_\_, \_\_. 2022.

**PËR  
GRUPET E INTERESIT  
PËRFAQËSUES TË AUTOSHKOLLAVE**

**SHOQATA KOMBËTARE E  
AUTOSHKOLLAVE**

**KRYETARI  
Agron BEJA**

**SHOQATA E AUTOSHKOLLËS  
“ SIGURIA NË RRUGË”**

**KRYETARI  
Behar LAZE**

**PËR  
DREJTORINË E PËRGJITHSHME  
TË TATIMEVE**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
Ceno KLOSI**

**PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME  
TË SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
Blendi GONXHJA**